



Administrata Tatimore e Kosovës
Poreska Administracija Kosova
Tax Administration of Kosovo

MEMORANDUM I BASHKËPUNIMIT

në mes të

ZYRËS SË KRYEPROKURORIT TË SHITETIT

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo	
Ministria e Financës dhe Transfereve / Ministarstvo za Finanse i Transfere	
Ministry of Finance and Transfers	
Administrata Tatimore e Kosovës / Poreska Administracija Kosova / Tax Administration of Kosovo	
KRYEVA / ARHIVA / ARCHIVE	
Niveli Org. Org. jedin. Org. unit:	8. Q
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	09-06-1556
Nr. Faqes Broj strana No paper:	1
Data Datum Date:	07/05/20
01	DALEŠE PRISHTINË

dhe

ADMINISTRATËS TATIMORE TË KOSOVËS

Maj 2020

DUKE KONSIDERUAR se Prokuroria e Shtetit, në një të anë, dhe Administrata Tatimore e Kosovës, në anën tjetër (më tutje: palët), synojnë të intensifikojnë bashkëpunimin e ndërsjellë dhe ngritjen e efikasitetit në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në Kosovë, duke forcuar mekanizmat e monitorimit dhe mbikëqyrjes së institucioneve për të kryer funksionin e tyre në mënyrë efektive, efektive, transparente dhe të përgjegjshme.

DUKE NDARË interesin dhe qëllimin e përbashkët për të zbuluar dhe luftuar veprat penale të korrupsionit, shpëlarjes së parasë dhe krimit të organizuar ashtu që të mbrohen interesat e përgjithshme publike të qytetarëve, ekonomisë, sistemit financiar të Republikës së Kosovës,

DUKE DITUR se qasja dhe shkëmbimi i shpejtë i të dhënave të caktuara që mblidhen dhe ruhen në bazën e të dhënave të Administratës, Tatimore të Kosovës (ATK), dhe të ndërlidhura me Doganës së Kosovës, Agjencionin për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK), Agjencionin për Regjistrimin Civil në Kosovë (ARC) dhe Njësinë e Inteligjencës Financiare (NjIF) lidhur me pasurinë e përgjithshme, mbi asetet e përgjithshme të anëtarëve të grupeve të organizuara ose të personave të korruptuar ashtu që të mund të luftohen me efektivitet dhe efikasitet veprat penale të cekura më lartë,

DUKE KONSIDERUAR, se Palët dëshirojnë që nëpërmjet një bashkëpunimi të tillë të mundësojnë dhe nxisin shkëmbimin e informacionit dhe eksperiencën mbi çështjet që ndërlidhen me luftimin e veprave penale të korrupsionit, shpëlarjes së parasë dhe krimit të organizuar; dhe

BAZUAR NË Kodin Penal të Republikës Kosovës, me Nr. 06/L-074; Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-123; Ligjin për Prokurorinë e Shtetit, Nr.03/L-225; Ligji për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-052; Ligjin për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr. 03/L-222 i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin 04/L-102 dhe Ligjin 04/L-223;

Palët dakordohen si me poshtë:

1. Qëllimi i memorandumit

Qëllimi i këtij memorandumit është mundësimi i komunikimit të drejtpërdrejt, të vazhdueshëm dhe të pandërprerë ndërmjet ATK-së dhe Prokurorisë së Shtetit, me qëllim që përmes përpunimit të dhënave të caktuara ATK-ja e pajisë Prokurorinë e Shtetit me të dhëna dhe informacione të mjaftueshme për nisjen dhe zhvillimin e hetimeve penale për veprat penale kundër korrupsionit, krimit të organizuar dhe shpëlarjes së parasë.

2. Objekt i memorandumit

Të dhënat të cilat ATK do t'i përpunojë, e që janë objekt i këtij memorandumit, përfshijnë gjitha të dhënat dhe informacione tjera kur vihet në pah ose konstatohet shpërputhje në mes të hyrave dhe shpenzimeve të një personi të caktuar ose personat që janë pjesë e grupeve, përfshirë dhe personat juridik që dyshohen se kanë kryer veprën penale që ndiqen nën juridiksionin e Prokurorisë së Shtetit. Këto të dhëna dhe informacione që do të përpunohen përfshijnë, por nuk kufizohen, në:

- të dhënat personale të tatimpaguesit si dhe personave dhe/ose familjarëve, njerëz të afërt me ta për të cilët përpunimi i të dhënave vë në pah ose konstaton shpërputhjen ndërmjet të hyrave dhe shpenzimeve;
- të gjitha të hyrat e regjistruara në ATK dhe institucionet tjera të sistemit financiar (*të dhënat nga banka komerciale, NJIF, institucionet mikrofinanciare*) përmes sistemit të të dhënave që institucionet i mbledhin që dhe i ruajnë të dhënat e qytetarëve në bazë të kompetencave ligjore;
- të gjitha shkëmbimet tregtare dhe të ngjashme, që ndërlidhen me subjektin ndaj të cilit zhvillohet përpunimi i të dhënave dhe subjekteve me të cilat evidentohet shkëmbim i shpeshtë tregtar apo i ngjashëm (*të dhënat nga ATK, ARBK, Dogana e Kosovës etj.*),
- të gjitha evidencat (*të dhënat nga ATK, Noteria, Agjencioni Kadastral i Kosovës*) rreth pasurive të paluajtshme që ndërlidhen me subjektin ndaj të cilit zhvillohet përpunimi i të dhënave dhe subjekteve me të cilat evidentohet shkëmbim i shpeshtë tregtar apo i ngjashëm, apo familjarëve të tyre të afërm, për aq sa këto të dhëna janë në dispozicion;
- të gjitha evidencat rreth pasurive të luajtshme (*të dhënat nga ATK, ARC, Dogana e Kosovës në ndërlidhje me të dhënat që mund të ndërlidhen edhe me shitjen dhe stërshitjen e automjeteve dhe pasurive tjera të luajtshme*), që ndërlidhen me subjektin ndaj të cilit zhvillohet përpunimi i të dhënave dhe subjekteve me të cilat evidentohet shkëmbim i shpeshtë tregtar apo i ngjashëm, apo familjarëve të tyre të afërm.

Në rastet kur nga përpunimi i të dhënave nga institucionet tjera, rezulton se subjekti nuk është tatimpagues i Kosovës, ky fakt evidentohet dhe përpilohet raport i veçantë për atë subjekt dhe dërgohet në Prokurorinë e Shtetit.

3. Shfrytëzimi dhe qasja në sistemin e të dhënave

- 3.1. Prokuroria e Shtetit të dhënat për personat fizik dhe juridik (*emri e mbiemri, data e lindjes, numri personal, numri i biznesit e numri unik identifikues, të dhënat nga regjistrimi i automjeteve, të gjitha deklaratimet tatimore etj.*), nga sistemet e informatave që mbledhen, përpunohen dhe ruhen nga Administrata Tatimore të Kosovës, do të i shfrytëzojë fillimisht pas pranimit të raportit javor nga zyrtari përgjegjës i ATK për të gjitha rastet duke filluar nga identifikimi përkatësisht kur identifikohet shpërputhja në mes të hyrave dhe shpenzimeve që ndërtohet mbi bazën e hetimit të bazuar mbi informatat inteligjente të cilat do të i prijnë hetimeve më të hollësishme lidhur me dyshimin e arsyeshëm ose dyshimin e bazuar gjatë fazës së hetimeve paraprake deri në ngritje të aktakuzës.
- 3.2. Palët u pajtuan që të gjitha të dhënat që do të merren duke e shfrytëzuar sistemin e të dhënave përmes ATK të përmendura në pikën 3.1 të këtij Memorandumi mund të përdoren si indikacion fillestar ose mund të kenë karakterin e "informatës" për Prokurorinë e Shtetit me qëllim zbulimit fillestar, parandalimit të kryerjes së veprës penale dhe zbulimin e kryerësve të veprës penale bazuar në nenin 91 të KPPRK për veprat penale të korrupsionit, krimit të organizuar, shpëlarjes së parasë dhe për veprat penale që gjenerojnë dobi pasurore siç përcaktohen me legjislacionin në fuqi.

- 3.3. Palët u pajtuan që ATK do të bëjë modifikimet e nevojshme në sistem përmes veglave elektronike që do të mundësojnë evidentimin automatik të shpërputhjeve në mes të hyrave dhe shpenzimeve të tatimpaguesit nga vet sistemi më ç' rast sistemi alarmon zyrtarin e ATK-së në mënyra automatike në lidhje me shpërputhjen e të hyrave dhe shpenzimeve. Zyrtari i ATK-së mund të bëjë përpunim të të dhënave edhe me vetë iniciativë, nëse vëren/identifikon shpërputhje e cila ka dalë nga sistemi ose me kërkesë të Prokurorit të caktuar me pikën 5.3 të këtij Memorandumi. Çdo shpërputhje në mes të hyrave dhe shpenzimeve të subjekteve që jetojnë dhe veprojnë në Kosovë në shumën prej 30,000 Euro e me shumë për pasurinë e luajtshme dhe në shumën prej 60,000 Euro e më shumë në pasurinë e paluajtshme evidentohet në raportin e ATK. E njëjta shpërputhje do të vendoset si algoritëm në veglën elektronike të ATK-së si pjesë e sistemit informativ të së njëjtës.
- 3.4. Përpilimi dhe dërgimi i raporteve javore (*në raste urgjente edhe më shpesht*), nga ATK te Prokuroria e Shtetit për çështjet që paraqiten si shpërputhje në mes të hyrave dhe të shpenzimeve për qytetarët e Kosovës dhe të cilat derivojnë nga analiza elektronike e sistemit informativ që gjendet i instaluar në ATK do të bëhet çdo të hënë të javës deri në orën 12:00.
- 3.5. Palët u pajtuan që Prokuroria e Shtetit, informatat e pranuar nga ATK do të i përdorë si informata për qëllimet e veta (*si pjesë e mandatit të së njëjtës*) dhe nëse ka bazë për të filluar dhe vazhduar ndjekjen penale ajo vet (*Prokuroria e Shtetit*) do të i ndjek procedurat për ligjshmërinë e provave që do të përdoren në procedurën penale.

4. Siguria e shkëmbimit të dhënave gjatë fazës së hetimeve

- 4.1. Palët u pajtuan që qasja e drejtpërdrejtë në bazën e të dhënave të bëhet përmes sistemit të sigurt për bartjen e të dhënave dhe do të realizohet përmes raportit nëpërmjet qasjes elektronike (*përmes e-mail*), në një sistem të mbrojtur elektronik dhe do të realizohet në mes të zyrtarit të autorizuar nga ATK për të shkëmbyer këto të dhëna me Prokurorinë e Shtetit. Palët u pajtuan që kjo mund të realizohet përmes shfrytëzimit kanalit të koduar (*enkriptuara*), për shkëmbimin e të dhënave të ATK dhe zyrtarit apo personit përgjegjës në Prokurorinë e Shtetit.
- 4.2. Detyrimi për të ruajtur të dhënat e besueshme të marra si rezultat i këtij Memorandumi ekziston edhe në rastet kur ka pushuar rëndësia përkatësisht ka pushuar arsyeja e marrjes së tyre dhe ruajtjes së tyre nga Prokuroria e Shtetit (p.sh. pas ngritjes së aktakuzës).
- 4.3. Prokuroria e Shtetit zotohet të i ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme me qëllim të ruajtjes së konfidencialitetit të dhënave të pranuar, dhe duhet të jenë në vend absolutisht të sigurt me kontroll rigoroz të hyrje daljeve.

5. Qasja në sistemin e të dhënave

- 5.1 Administrata Tatimore e Kosovës bën përpunimin e të dhënave në sistemin e tyre të cilat i përditëson nga brenda (*informatat e tyre nga sistemi tatimor*) dhe pranon të dhëna të cilat i kërkon, përpunon dhe i ruan në mbështetje të nenit 15 të Ligjin Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin 04/L-102 dhe Ligjin 04/L-223

dhe të cilat mund të i zbulojë sipas detyrës zyrtare me Prokurorinë e Shtetit në mbështetje të nenit 84 par. 2 të ligjit të cekur më lartë.

- 5.2 Administrata Tatimore e Kosovës, cakton me vendim nga Drejtori i ATK, pas konsultimit me Prokurorin e Shtetit, zyrtarin e vet që ka autorizim për qasje të pa limituar në sistemin i cili është instaluar dhe funksionon për interesat e ATK të i ofrojë informata fillimisht përmes raporteve javore për Prokurorinë e Shtetit dhe të jetë në dispozicion për të analizuar, lexuar, vlerësuar dhe interpretuar këto të dhëna të cilat janë pjesë e raportit të nxjerrë.
- 5.3 Prokurori i Shteti i caktuar nga Kryeprokurori i Shtetit për të pranuar dhe bashkëpunuar me zyrtarin e caktuar të ATK-së pranon dhe diskutojnë lidhur me të dhënat dhe bën raport mujor tek Kryeprokurori i Shtetit. Të dhënat statistikore nga ky raport ndahen edhe me ATK.
- 5.4 Vetëm zyrtari i ATK është i autorizuar për qasje në sistemin e të dhënave të ATK, që janë subjekt i këtij memorandumi, dhe ka të drejtë që ti shfrytëzojnë të dhënat që kanë të bëjnë me evidencat lidhur me paluejtshmëritë, llogaritë bankare dhe transaksionet bankare të siguruara përmes raporteve të inteligjencës nga ana e Njesisë së Inteligjencës Financiare, e definuar me Ligjin për parandalimin e shpëlarjes së parasë dhe financimin e terrorizmit, Nr. 05/L-096 qarkullimit të mallrave përmes pikave doganore dhe evidencës lidhur me regjistrimin e së drejtës së pronësisë në regjistrin kadastral për aq sa është e lejuar me ligj dhe e regjistruar në regjistrat përkatës të shtetit.

6. Detyrimet e ndërsjella

- 6.1. Palët pranojnë që kanë detyrim ligjor që të gjitha informacionet e siguruara gjatë qasjes në sistemin informativ të dhënave janë subjekt i "Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", Nr. 03/L-172. Zbulimi i paautorizuar do të ndiqet penalisht në bazë të ligjeve të zbatueshme në Kosovë.
- 6.2. Palët u pajtuan që shpenzimet e fillestare lidhur me zbatimin e këtij Memorandumi për sa i përket pajisjeve të informatikës dhe komunikimit do të mbështeten nga Zyra e UNDP në Kosovë përmes asistencës teknike dhe nevojave teknologjike dhe u zotuan që pas funksionalizimit të këtij sistemi secila palë veç e veç do të marrin përsipër mirëmbajtjen e sistemit për zbatimin e këtij Memorandumi.
- 6.3. Palët u pajtuan që Administrata Tatimore e Kosovës, sipas nevojës, të marrë përsipër edukimin e shfrytëzuesve të dhënave nga ana e Prokurorisë së Shtetit në bazë të nevojave dhe planit funksional (*operacional*) që do të aprovohen me aneks të veçantë pas nënshkrimit të këtij Memorandumi dhe palët nënshkruese të këtij Memorandumi të bashkëpunojnë me Prokurorinë e Shtetit në çështjen e analizimit dhe verifikimit e fakteve sipas nevojës së Prokurorisë së Shtetit. Plani dhe aktivitetet specifike operacionale sipas nevojës do të aprovohen jo më shumë se gjashtëdhjetë (60) ditë nga dita e nënshkrimit të këtij Memorandumi.

7. Dispozitat përfundimtare

- 7.1. Ky Memorandum do të aplikohet përshtatshmërisht edhe në rastet kur ligjet bazë të fushave që përfshijnë mandatin e institucioneve zbatuese të njëjtin do të amandamentohen, ndryshohen ose zëvendësohen me legjislacion të ri.
- 7.2. Çdo çështje në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e këtij Memorandumi do të zgjidhet miqësisht nëpërmjet konsultimeve mes palëve nënshkruese.
- 7.3. Çfarëdo plotësimi apo ndryshimi i këtij Memorandumi do të bëhet duke u dakorduar me shkrim dhe do të pranohet nga palët nënshkruese në formën e duhur
- 7.4. Ky Memorandum është nënshkruar në dy (2) kopje origjinale për secilin palë nënshkruese.
- 7.5. Asnjëra palë nuk do të caktojë, transferojë, premtojë ose të bëjë dispozita të tjera të të drejtave sipas këtij Memorandumi ose të ndonjë pjese të tij, përveç me pëlqimin paraprak me shkrim të të gjitha palëve nënshkruese.

8. Hyrja në fuqi

Ky Memorandum i Bashkëpunimit hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga të gjitha palët.

Palët nënshkruese:

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit



Aleksandër Lumezi, Kryeprokuror

Administrata Tatimore e Kosovës



Ilir Murtezaj, Drejtor

Data:

07.05.2020

Data:

07.05.2020

